



Republika e Kosovës - Republic of Kosova

Komuna – Municipality

Hani i Elezit



Nr. 07/ 3195/2021

DATA:	27.04.2021
PËR:	z. Rufki Suma, Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Medina Imishti, Drejtoreshë për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale
TEMA:	Raporti vjetor për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale Janar-Dhjetor 2020, Hani i Elezit

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Raport i Punës

Janar - Dhjetor 2020

- Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020 DSHMS ka pasur këto aktivitete:
- Është punuar dhe janë kontrolluar aktivitetet e QKMF- së dhe AMF-së për ngritjen e diciplinës së punës.
 - Kërkesa të vazhdueshme në MSH për rritje të stafit në sektorin e Shëndetësisë.
 - Marrëveshje bashkëpunimi me Islamic Relief Worldwide për 11 puntorë shëndetësorë.
 - Renovimi i Emergjencës (Është bërë ndërrimi i plastikës së dyshemes në dhomën e reanimimit dhomën e mjekut, dhe në dhomën e infuzioneve. Është bërë lyerja e dhomës së reanimimit, mjekut dhe e infuzioneve. Është bërë ndërrimi i dritave në të njëjtat dhoma. Është bërë ndërrimi i roletave në këto dhoma si dhe jemi furnizuar me aparate mjekësore: EKG(Elektrokardiogram), Monitor, Aspirator, Defibrilator, 6 Shtretër tek dhoma e infuzioneve si dhe inventar dollap për barna, karrika për mjek dhe karriga për pacienta si rezultat i bashkëpunimit me Kforin Turk (Donacion).
 - Renovimi i Mjekësisë Familjare (Është bërë lryja e gjithë hapësirës brenda mjekësisë familjare (në të gjitha dhomat), ndërrimi i gjitha dyerve, ndërrimi i lavaborëve, roletave, banjove, ndriqimi, kartoteka, ndërtimi i bifës, ulëse për pacinetë, televizore për promovim të shëndetit (edhe në sektorin e emergjencës), renovimi i RTG-së, barnatores qëndrore, paisja me inventar të nevojshëm(Investim nga DSHMS).
 - Kemi bërë furnizimin me një monitor, tre oksigjeno koncentrata, dhe jemi furnizuar me material medicinal si ampulare që nuk janë në listën esenciale dhe reagensa për laborator.
 - Nga UNICEF-i jemi furnizuar me paisje personale mbrojtëse (dorëza, maska, dezinfektues.) një Oksigjeno Koncentrat për pesë persona si dhe material higjienik për nana dhe fëmijë si dhe për shtatëzana. Me material higjienik nga UNICEF është furnizuar edhe QKMF.
 - Furnizimi i rregulltë me barna dhe material mjekësor nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë.
 - Planifikimi i vaksinimit dhe imunizimit të mbi 95% të fëmijëve.
 - Zvoglimi i morbiditetit (smundshmërisë) dhe mortalitetit (vdekshmërisë) të nënave shtatëzana dhe fëmijëve të posalindur.
 - Transportimi i rregulltë i pacientëve në Hemodializë në Ferizaj (ditën e hënë, mërkure dhe premtë).
 - Përcellja e punës dhe sigurimi i funksionimit në ambulancën e fshatit Gorancë. Gjatë periudhës Mars-Gusht ama nuk ka punuar për për kontrolla mjekësore për shkak të reduktimit të shërbimeve dhe nevojës për mjek e infermier në QKMF dhe në pikën kufitare.
 - Mbajtja e pastërtisë dhe ambientit të këndëshëm për punë.

- Mbajtja e rregulltë e takimeve të Këshillit drejtues dhe atij profesional.
- Bashkëpunimi me Organizatat vendore jo qeveritare dhe qeveritare.
- Organizimi i aksionit vullnetar për dhurimin e gjakut.
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
- Raportimi i rregulltë në IKSHP- rajonale për sëmundjet ngjitëse dhe tumoreve (kancerit) dhe sëmundjeve kronike në IKSHP-në në Prishtinë.
- Bashkëpunimi me Qendrat tjera të mjekësisë familjare të komunave, veçanërisht gjatë pandemis ku janë bërë kontrolla mjekësore në pikën kufitare të vendkalimit të këmbësorëve dhe pikën doganor.
- Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore në QKMF dhe sigurimi i lëndës djegëse (dru) në AMF Gornacë.
- Ruajtja e sekretit profesional dhe konfidencës në raportet e pacientëve.
- Është krijuar edhe linja telefonike pa pangës për kërkim të ndihmës mjekësore dhe informacione falas me numër (0800 15 550).
- Kryerja e testeve serologjike (3,000 teste).

DSHMS-ja gjatë kësaj periudhë ka punuar me një staf prej 34 punëtorëve :

Nr.	Shërbimi /Sektori	Vendi i punës	Staf
1	Administratë e DSHMS-së	Drejtoreshë	1
		Shefi DSHMS-së	1
2	QKMF	Drejtor	1
		Mjek	6
		Kryeinfermiere	1
		Infermier	18
		Laborant	1
		Teknik i radiologjisë	1
		Farmaciste	1
		Puntorë teknik	3

Për përmirësimin e shërbimit shëndetësor shtëpiak, gratë shtatzëna ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ndaj qytetarëve, një kujdes shtesë për familjet në nevojë në komunën e Hanit të Elezit dhe në veçanti në zonat rurale të kësaj komune DSHMS-ja, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Islamic Relief Ëordëide për njëmbëdhjet punëtorë shëndetësor.

- Punëtorët të QKMF-së në bashkëpunim me organizatën ‘‘Islamic Relief Worlwide’’.

Nr.	EMRI	MBIEMRI	POZITA
1.	Fadil	Gashi	Mjek /Pediatër
2.	Isa	Berisha	Mjek / Internist
3.	Arbnora	Kaloshi	Mjeke e Përgjithshme
4.	Valbona	Bajramaliu	Infermiere/ Mami
5.	Malik	Berisha	Infermier
6.	Ilire	Azemaj	Infermiere
7.	Zebushe	Reqi	Infermiere
8.	Doruntina	Dernjani	Infermiere
9.	Arlinda	Thaqi	Infermiere

edhe këtë vit për të dytën herë në nivel vendi është shpërblyer edhe me një laptop nga Ministria e Shëndetësisë.

Muajt	Vaksinimi		Vizitat për Nëna dhe fëmijë	
	2019	2020	2019	2020
Janar	62	70	30	47
Shkurt	220	47	52	35
Mars	289	50	55	16
Prill	85	00	51	00
Maj	80	86	50	45
Qershor	113	107	44	35
Korrik	52	66	40	53
Gusht	72	61	53	62
Shtator	68	208	54	60
Tetor	51	175	52	64
Nëntor	57	459	50	57
Dhjetor	594	629	51	58
Totali	1,743	1,958	582	532

▪ **Sektori i Diagnostikës**

Gjatë kësaj periudhe për analiza Laboratorike dhe Rentgenologjike janë siguruar material i domosdoshëm për punë, kështu që janë ofruar shërbime si kuantitative (sasiore), po ashtu edhe kualitative, (cilësore). Sigurimi i reagensëve për analiza laboratorike që janë mungesë në listën e barnave esenciale dhe sigurimi i disa medikamenteve dhe materialit shpenzues për mbulimin e shërbimeve shëndetësore janë siguruar nga buxheti komunal.

Furnizimi edhe me aparat laboratorik që mund të kryhen edhe këto analiza (CRP, TSH, T₃, T₄, HbA_{1C}).

Po ashtu kjo aparaturë laboratorik e siguruar nga buxheti komunal i DSHMS-së do të kryerj edhe testet serologjike për COVID 19 ku reagensat po ashtu janë siguruar nga DSHMS –ja.

Rastet e referuara për testim PCR për virusin Covid-19 nga QKMF, IKSHPK ka obliguar të keni edhe RTG.

Muajt	Laboratori		RTG-ja	
	2019	2020	2019	2020
Janar	237	322	49	32
Shkurt	295	200	39	45
Mars	290	88	39	18
Prill	00	00	47	3
Maj	00	00	35	13
Qershor	59	173	36	47
Korrik	271	97	68	30
Gusht	229	155	39	30
Shtator	336	242	54	00
Tetor	332	231	51	35

Nëntor	283	132	44	86
Dhjetor	881	881	46	43
Totali	3,213	2,521	547	382

▪ **Sektori i Emergjencës**

Ky sektor ka ofruar shërbime 24/7, i cili ka qenë një nga prioritetet në organizimin, menaxhimin dhe furnizimin me medikamente dhe material shpenzues si: shiringa, gjilpëra, material për fashim. Për menaxhim të rasteve në këtë sektor shërbimet janë ofruar edhe jashtë QKMF-së, dhe rastet emergjente që i referohen nivelit sekondar dhe terciar, sipas thirrjeve nga ana e pacientëve, poashtu edhe zyrtarve policor dhe institucioneve në menaxhimin e emergjencave.

Vizitat shtëpiake tek pacientët me COVID-19.

DSHMS –së gjithashtu ka arritur të krijoj përveç linjës 194 dhe një linjë tjetër telefonike pa pangës për kërkim të ndihmës mjekësore dhe informacione falas me numerin (0800 15 550) numer ky i ekspozuar edhe në objektin e QKMF-së.

Muajt	Emergjencia		Vizitat shtëpiake	
	2019	2020	2019	2020
Janar	1,471	1,326	64	133
Shkurt	1,351	1,222	63	114
Mars	1,334	1,210	49	76
Prill	1,070	420	60	25
Maj	823	479	151	59
Qershor	1,088	850	56	76
Korrik	1,160	804	78	52
Gusht	1,178	589	82	104
Shtator	1,058	529	91	64
Tetor	940	998	74	114
Nëntor	958	770	31	182
Dhjetor	1,035	802	101	175
Totali	13,736	9,998	900	1,138

▪ **Shërbimet në Ambulantën e Mjekësisë Familjare në Gorancë**

AMF Gorancë ka ofruar shërbime shëndetësore qdo ditë vetëm në ndërrimin e paraditës dhe me mundësi vizitë të mjekut dy herë gjatë javës (të martën dhe të enjten).

Muajt	Kontrollat mjekësore		Intervenime		Vizitat Shtëpiake		Vizitat për nëna dhe fëmijë		Participimi	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Janar	00	19	25	34	14	8	9	00	3	00
Shkurt	00	47	65	20	00	6	6	00	0	00
Mars	00	00	76	49	11	3	11	00	0	00
Prill	00	00	94	00	11	00	6	00	2	00

Maj	00	00	74	00	4	00	5	00	0	00
Qershor	00	00	71	8	3	3	4	00	0	00
Korrik	00	00	30	00	7	00	4	00	3	00
Gusht	00	00	10	00	7	00	3	00	3	00
Shtator	41	117	20	82	6	11	3	00	2	00
Tetor	40	18	34	59	7	3	00	00	3	5
Nëntor	10	00	32	44	10	10	7	3	2	1
Dhjetor	29	00	78	96	23	23	13	5	3	1
Totali	159	201	719	392	129	67	83	8	20	7

▪ Shërbimet specialiste

Shërbimi	2019	2020
Pediatri	2,040	1,934
Internistike	1,100	1,229
Totali	3,140	3,163

▪ Rastet e sëmundjes me - CA

Lloji i sëmundjes	Nr i rasteve		Gjinia			
	2019	2020	2019		2020	
CA PULMO	6	0	F-1	M-5	F- 0	M-0
CA ENDOMETRIUM	1	1	F-1	M-0	F- 1	M-0
CA PROSTATES	1	0	F-0	M-1	F- 0	M-0
CA MAMAE	4	3	F- 4	M-0	F- 3	M-0
CA Faringitis	2	1	F- 1	M-1	F- 1	M-0
Ca Laringitis	0	1	F-0	M-1	F-0	M-1
Ca Rectum	0	1	F-1	M-0	F-1	M-0
Tu Cerebri	1	1	F-0	M-1	F-0	M-1
Totali	15	8	F-6	M-9	F- 6	M-2

- Trajnimet -Të gjitha trajnimet për stafin shëndetësorë për shkak të pandemis janë mbajtur online.

Infermier/e:

- 12.02.2020 -“Roli dhe rëndësia e komunikimit të punëtorëve shëndetësor”
- 26.02.2020 –“Shërbimet shëndetësore në fatkeqësi dhe emergjenca.”
- 02.03.2020 –“Kujdesi shëndetësor për individët me Sindromin Doën.”
- 09.04.2020-Ndikimi i gjendjes pandemike covid-19 ne implementimin e programit te vizitave ne shtëpi.

- 07.08.2020-Rezistenca antimikrobiotike dhe përshkrimi i antibiotikeve.
- 11.09.2020-Përdorimi i platformës elektronike –Kolegji Riinvest
- 13.09.2020-Përdorimi i aplikacioneve on-line
- 16.10.2020-Parandalimin dhe kontrollin e infeksionit.
- 20.10.2020-Prezentimi i udhëzuesit për realizimin e Vizitave Shtëpiake
- 29-30.06.2020-"Së bashku për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë"

Mjek/e:

- 07.08.2020-Rezistenca antimikrobiotike dhe përshkrimi i antibiotikeve.
 - 20-22.05.2020- Planifikimi Familjar
 - 28-29.05.2020-Dhuna në baza gjinore-on-line.
- Shënimi i ditëve ndërkombëtare në shëndetësi
Sa i përket aktiviteteve në shënimin e ditëve ndërkombëtare janë anuluar këto aktivitete për shkak të pandemis ,mirepo meqenëse u krijua nje situat e re ne si QKMF kemi ofruar informim në të gjitha shkollat e Komunës kemi mbajtur takim me Drejtoret dhe arsimtaret e shkollave per Pandemin Covid 19.
- Donacione

Nr.	Emri gjenerik	Sasia	Donatori
1	Mburojë per fytyre	50	Bonevet
1	Dorza Medium	1000	SHARRCEM
2	Maska kirurgjike	350	SHARRCEM
3	Dezifektues 300 ml	8	SHARRCEM
4	Etanol 95 %	100	Ballkan Petrol
5	Dezifektues 250 ml	36	Madkos
6	Povidon jod	2	Madkos
7	Rroba	10	Madkos
8	Shiringa 10 ml	600	Madkos
9	Syze mbrojtëse	10	Madkos
10	Termometra	10	Nili Pharm
11	Kellef jastiku	20	Bekim Ramadani
12	Qarshaf për shtretër	30	Bekim Ramadani
13	Batanije (qebe)	20	Bekim Ramadani
14	Qarshaf për shtretër	34	Bekim Ramadani
15	Kellef jorgani	34	Bekim Ramadani
16	Oksigjeno koncentrat	2	Fondacioni Labinot Tahiri
17	Dezinfektues automatic	2	Shkolla Fillore ‘‘Ilaz Thaqi’’
18	Dezinfektues automatic	1	Unicef
19	Material higjienik (sprej, palloma tlagta, xhokera)	10	Unicef
20	Alkool	20	Unicef

▪ Mungesat nga lista esenciale

Nr.	Emri gjenerik	Sasia
1	Oksigjen	720 L
2	Lidocain amp. 1%	360
3	Brufen sir.	1200
4	Brufen tbl.	36000
5	Buscopan amp.	2400
6	Loratidin sir.	360
7	Loratidin tbl.	360
8	Atropin amp.	12
9	Diazepam gel.	60
10	Fenobarbitol tbl.	1800
11	Amikacin amp.	360
12	Amoxyl tbl.	7680
13	Amox tbl.	600
14	Cefalecin sir.	240
15	Cefazolin tbl.	600
16	Metronidazol tbl.	3600
17	Bactrim tbl.	7200
18	Azitromycin tbl.	3600
19	Ceftriacone amp.	3600
20	Methylprednisolon amp.	3600
21	Anti D immunoglobulin	36
22	Bisoprolol tbl.	25200
23	Methyldopa tbl.	3600
24	Etanol 70%	240
25	Omeprazol inj.	2400
26	Ondasetron amp.	120
27	Metoclopramide tbl.	10800
28	Ergometrin amp.	60
29	Salbutamol pika	120
30	Gkucose 5% 500 ml	240
31	Ringer sol 500 ml	1200
32	NaCl 100 ml	2400 (kohë pas kohe)
33	Vat (pambuk)	240
34	Role gaz	240 (kohë pas kohe)
35	Leukoplast (flastera)	360
36	Ac. Boric	60
37	Vazelin	120
38	Diclofen gel	360
39	Captopril tbl.	1800 (kohë pas kohe)
40	Gentian violet	60
41	Glimepirid tbl.	18000

42	Sisteme te infusioneve	6000
43	Shiringa 10 ml	12000
44	Shiringa 5 ml	2400
45	Gjilpera 21 G	24000
46	Gjilpera 23 G	6000
47	Gjilpera 19 G	24000
48	Kateter nr. 18	120
49	Kateter nr. 20	120
50	Kanilla 24 G	12000 (kohë pas kohe)
51	Kanilla 22 G	12000 (kohë pas kohe)

AKTIVITETET GJATË PANDEMISË - COVID-19:

- Organizimi i kujdestarisë në pikën kufitare dhe terminalin doganor ka qenë përgjegjësi e Sektorit të Shëndetësisë - drejtorisë së QKMF në Han të Elezit e cila ka organizuar dhe funksionalizuar kujdestarin 24 orë në pikën kufitare dhe terminalin doganor.
- Mos marrja e përgjegjësisë për organizimin dhe kordinimin e kujdestarisë në pikën kufitare dhe terminalin doganor në Han të Elezit nga organet qendrore, atëherë nga organet drejtuese komunale dhe sektori i shëndetësisë janë obliguar të kërkojnë ndihmë nga komunat fqinje dhe komunat tjera që të organizohet dhe koordinohet kujdestria në pikën kufitare dhe terminalin doganor.
- Organizimi i kujdestarisë 24 orë i kontrollit mjekësor i të gjithë udhëtarëve që hyjnë në pikën kufitare dhe vozitësve të mauneve në terminalin doganor, kontrolla në kufi ka filluar me 18 shkurt 2020, kujdestaria 24 orë nga 15 marsi 2020, fal solidaritetit të komunave: Kaçanik, Ferizaj të cilat nga kjo datë rregullisht kanë kujdestaruar me një ekip, ndërsa Vitia derisa janë paraqitur rastet e koronavirusit kanë qenë të rregullt me një ekip, pas praqitjes koronavirusit në këte komunë nuk kanë kujdestaruar, me disa kujdestari gjatë muajëve prill dhe maj kanë ndihmuar: Prishtina, Shtimja, Gjilani dhe Obiliçi.
- Raportimi ditor i QKMF-së në IKSHPK për numrin e personave që hyjnë në pikën kufitare duke i ndarë në udhëtar dhe vozitës.
- Një ndër problemet me personat që kanë hyrë në Kosovë në këte pikë kufitare të cilët kanë shkuar në karantin, gjatë javës parë nuk ka qenë definuar se kush është përgjegjës për transportin nga pika kufitare deri në qendrën e karantinimit, zakonisht policia kufitare, ju drejtojshin komunës ose QKMF-së, deri sa ky problem u definuar pas komunikimit me organet qendrore konkretisht MPB-në se përgjegjëse është FSK-ja.
- Me mungesë resuseve humane dhe profesionale për organizimin dhe funksionalizimin e kujdestarisë në pikën kufitare dhe terminalin doganor, sepse komuna jonë edhe para fillimit të krizës me koronavirus ka pasur mungesa të personelit shëndetësor për mbulimin e gjitha shërbimeve shëndetësore.
- Një ndër problemet e kujdestarisë është edhe shtypja/printimi i çeklistave-Formularëve të IKSHPK-së të cilët plotësohen për çdo udhëtar/voztës që hynë në

kufi apo në terminal doganor, nga 18 shkuri deri në fund të qershorit 2020, zyrtarisht në kufirin e Hanit të Elezit kanë hyrë gjithsej (udhëtar/voztës të mauneve) 51362 prej tyre 26259 udhëtar (shih. tabelën e frekuencë në pikën kufitare në Han të Elezit prej 18 shkurt deri në fund qershorit 2020 sipas frekuencës ditore), formularët janë dy pjesë atëherë komuna deri më tani është obliguar ti siguroj dhe të i shtyp afër 100 mijë fleta.

- Kontrollimet dhe plotësimi i formularëve të aprovuar nga IKSHPK (të dhënat personale, telefoni, relacioni i udhtimit) kanë filluar me 18 shkurt 2020.
- Kontrollimet janë realizuar sipas kërkesë së policisë kufitare të cilët kanë kërkuar mendimin e ekipit mjekësor.
- Gjatë këtyre kontrollave në javët e para ka pas probleme sepse QKMF-ja nuk kanë qenë e furnizuar me mjete për mbrojtje nga Covid-19 por vetëm me paisje elementare mjekësore maskë dhe dorëza pra ekipet që kanë kryer kontrollat e udhëtarëve ju kanë nënshtruar rrezikut të infektimit apo të bartjes së virusit Covid-19.
- Priudha Mars-qershor, bartëse të organizimit të kujdestarisë 24 në pikën kufitare dhe terminalin doganor kanë qenë komunat: Hani i Elezit, Kaçanik dhe Ferizaj për çdo ditë nga një ndrrim 8 orësh ndërsa disa herë kanë ndihmuar: Vitia, Shtimja, Obiliç.
- Periudha tetor-dhjetor, bartëse të organizimit të kujdestarisë 24 në pikën kufitare kanë qenë komunat: Hani i Elezit, Ferizaj dhe Viti për çdo ditë nga një ndrrim 8 orësh.
- Raportimi ditor në IKSHPK për numrin udhëtarëve/voztësve të cilët kanë hyrë në Republikën e Kosovës gjatë 24 orëve të fundit gjatë periudhës mars-qershor 2020.
- Zbatimi i vendimeve të institucioneve qendrore për parandalimin e përhapjes së koronavirusit.
- Dezinfektimi i QKMF-së në baza ditore.
- Dezinfektimi i objekteve publike.
- Bashkëpunimi me drejtor të shkollave për organizimin e mësimit nga distanca-online
- Bashkëpunimi me organet e sigurisë dhe inspektoratit në zbatimin e masave për parandalimin e koronavirusit
- Menaxhimi dhe koordinimi me IKSHPK me rastet pozitive dhe rastet e dyshuara në komunë.
- Për arsye të mbrojtjes së jetës së qytetarëve dhe prandalim të rritjes së infeksionit nga pandemia COVID-19 gjatë muajit prill në disa sektor është ndërpre përkohësisht dhënia e shërbimeve si: Vaksinimi, kujdesi për nënën dhe fëmijun, shërbimet specialistike, AMF andaj edhe numri i shërbimeve është më i vogël krahasuar me shërbimet që jepen në QKMF ” Dr.Menduh Kaloshi”.
- Me rekomadim të MSH dhe IKSHPK-së nga ekipet mjekësore në pikën kufitare janë liruar nga karantina një kategori e caktuar e personave nga ta, personat mbi moshën 70, personat me sëmundje kronike, gratë shtatëzëna, personat në kimio-terapi.
- Është përgaditur dhe orari i barnatoreve për muajin Prill, është përcjellur tek pronarët dhe OFK dhe është rekomaduar se barnatotret duhet në orarin e përcaktuar nga DSHMS të jenë në gadishmëri.
- Që kur ka filluar lehtësimi i masave për disa aktivitete, për stafin shëndetësor angazhimi dhe përkushtimi është shtuar dukshëm, duke pasur parasysh se tani kemi rrezik më të madh pasi që edhe kontaktet do të shtohen.
- Pran objektit të QKMF" Dr.Menduh Kaloshi" në Han të Elezit në muajin Mars është vendosur tenda e cila do të shërbej për triazhimin e gjithë pacientëve të dyshuar me COVID-19. Kjo tend është vendosur nga ana e Kryqit të Kuq të Kosovës.

▪ Kujdestaria :

Shkurt		Mars		Prill-Maj-Qershor
Kujdestaria	Institucioni kujdestar	Ndërimet e kujdestarsë	Institucioni kujdestar	Institucioni kujdestar
24 orë	QKMF Hani i Elezit	7:00-15:00	QKMF Hani i Elezit	QKMF Hani i Elezit
Kontrolla ka filluar me: 18.02.2020 Kontrollat kanë qenë sipas rasteve kur policia ka kërkuar ndihmë nga personeli mjekësor, të gjitha kontrollat janë realizuar nga Ekipe të QKMF në Han të Elezit		15:00-23:00	QKMF-të Kaçanik Ferizaj	QKMF-të Kaçanik Ferizaj
		23:00-7:00	Nd. Natës Hani i Elezit (sipas nevojës)	QOEK Vullnetar Hani i Elezit Kaçanik Shtime Prishtinë

Vrejtje: Me disa herë kujdestari në ndërimin e dytë nga 15:00-23:00 kanë ndihmuar:

Komunat:

1. Viti-deri sa janë paraqitë rastet e koronavirusit në komunën e Vitisë
2. Gjilan-disa herë
3. Shtime-disa herë
4. Obiliçi-disa herë

- Kujdestari vazhdon të organizohet dhe funksionalizohet nga DSHMS në Han të Elezit edhe gjatë vitit 2021.
- Bashkëpunimi me donator të ndryshëm për sigurimin e ndihmave për familjet të cilat kanë pasur nevojë të ndihmohen.
- Gjatë periudhës së izolimit nga pandemia koronavirus u ndihmuam nga: Viva Fresh Store-Buçaj, ELKOS-DEVOLLI, Fondacioni LABI-“Labinot Tahiri”, Fondacioni “FIRDEUS”, Kryqi i Kuq i Kosovës -dega Kaçanik, SH.P.K ALBAGRUP-Sherif Ramuka, UNICEF-Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet,SH.B “Jetimat e ballkanit”-Halil Kastrati, SH.P.K MERIDIAN express, Fondacioni” Freskia”, BONEVET Kaçanik, MADEKOS medikal- pajisje mjekësore, O.H.ZH ISLAMIK RELIEV NË KOSOVË, TIKA-agjencia Turke për bashkëpunim dhe koordinim në Kosovë, SH.P.K ILIONGRUP, WAMY-Asamblea botërore e rinis muslimane-në Kosovë, UNMIK-zyra e OKB për komunitete Kosovë, RTV DARDANIA.LIVE në Zvicër, Ballkan Petrol.
- Me rastin e festës së kurban bajramit ndihmuam:1000kg mish për 200 familje Jetimat e Ballkanit, 121 pako me nga 7kg mish nga Islamik Reliev Kosova.
- U ndihmuam 368 +321=689 familje me 1121+321=1442 pako,

- FSK donacionin me pajisje mbrojtëse mjekësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr.Menduh Kaloshi", donacion përmbante pajisje mbrojtëse mjekësore; maska të llojeve të ndryshme, dorëza, rroba, mburoja për fytyrë, kapele kirurgjike, si dhe materiale tjera përcjellëse.
- Pjestarë të KFOR-it Italian që janë në shërbim në kuadër të forcave të NATO-s në Kosovë, sot dhuruan një kontingjent të ndihmave në pajisje për nevoja të QKMF "Dr.Menduh Kaloshi", donacioni përmbante: Defibrilator, Aspirator, Monitor, Nebulizator, Oksigjenokoncentrat, Oftalmoskop, Otoskop, Tensiometër, Pirun Akustik, Spekulum për hundë për fëmijë, Spekulum për hundë për të rritur, Peshore për fëmijë dhe të rritur.
- Fondacioni Labinot Tahiri donacion 2 aparate për oskigjeno-koncentrat
- Besim Ramadani nga Shkupi, pronar i Kompanis Ami Plus Store i cili dhuron për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Menduh Kaloshi" 20 jastik, 20 batani, 60 qarshaf, 35 mbulesa për shtretër, 35 mbulesa për jastik dhe 15 qarshaf për paravan.
- Paraqitja e rasteve me COVID 19 -Rasti i parë i infektuar me koronavirus në komunën tonë paraqitet me 10 prill 2020, burim i infeksionit ishte nga Kampi BONSTIL, sepse i infektuari ishte puntor i një ndërmarrje që kryente shërbime në këtë Kamp nga ky rast u infektuan edhe 6-gjatë raste të tjera të kontaktit (5-familjarë dhe një fqinjë e të infektuarit).
- Komuna e Hanit të Elezit gjashtë mujorin e parë të vitit 2020 e kaloi me këto 7-shtatë raste të infektimit me koronavirus.
- Me 3 korrik 2020 paraqitet rasti parë në gjashtëmujorin e dytë, tani rastet me një ndryshim në muajin Gusht me numër më të madh të infektuarëve ndërsa numri më i madh i të infektuarëve me koronavirus në komunën tonë është në nëntor 2020 me 29 të infektuarëve.
- Nga rastet e të infektuarëve kemi dy raste të vdekjes si pasoj e koronavirusit 1 në shtator dhe 1 një dhjetor.

Në vazhim po japim tabelën e përhapjes së koronavirusit në komunën tonë përmes rasteve, aktive, të infektuarëve, të hospitalizuarëve dhe të vdekur sipas muajëve të vitit 2020.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Pozitiv-aktiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2
Të inf. me COVID 19	0	0	0	7	0	0	6	10	9	7	29	10	78
Të hospitalizuar	0	0	0	0	0	0	3	1	2	0	6	3	15
Të dysh. me diag. klinike	0	0	0	0	0	0	18	43	10	15	62	22	170
Të vdekur	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1	2

Statusi i të infektuarve dhe gjinia

Statusi		%
Shëruar	74	92.21
Aktiv	2	5.19

Vdekur	2	2.60
Gjithsej	78	100.00

SHPËRNDARJA E TË INFEKTUARËVE SIPAS, VENDBANIMEVE, PROFESIONEVE, MOSHAVE DHE GJINISË

- Sipas vendbanimeve më i infektuar është:
 - o Hani i Elezit me 45 të infektuar apo 57.69% të infektuarëve,
 - o Lagja e re me 12 të infektuar apo 15.38% e të infektuarëve,
 - o Paldenica me 9 të infektuar apo 11.54% e të infektuarëve,
 - o Seqishta me 8 të infektuar apo 10.26% e të infektuarëve etj
- Sipas profesioneve më të infektuar janë:
 - o puntorët dhe pensionistat me nga 19 të infektuar apo me nga 24% e të infektuarëve,
 - o puntorët shëndetësor dhe amviset me nga 13 të infektuar apo me nga 16.67% të infektuarëve,
 - o të pa punë 9 të infektuar apo 11.54% e të infektuarëve etj.
- Sipas moshave me të infektuar janë:
 - o Mosha 60-70 vjet me 17 të infektuar apo me 21.79% e të infektuarëve
 - o Mosha mbi 70 vjet me 15 të infektuar apo 19.23% e të infektuarëve
 - o Mosha 30-40 vjet me 14 të infektuar apo 17.95% e të infektuarëve
 - o Mosha 40-50 vjet me 12 të infektuar apo 15.38% e të infektuarëve
 - o Mosha 50-60 vjet me 10 të infektuar apo 12.82% e të infektuarëve
 - o Mosha 20-30 vjet me 7 të infektuar apo 8.97% e të infektuarëve
- Sipas gjinisë me të infektuar:
 - o Meshkuj 42 të infektuar apo 54.55% e të infektuarëve
 - o Femra 36 të infektuara apo 45.45% e të infektuarëve

REZULTATET E TESTEVE SEROLOGJIKE PRANË QKMF “DR.MENDUHKALOSHI” NË HAN TË ELEZIT

Komuna e Hanit të Elezit pas rishikimit të buxhetit ndau një shumë të mjeteve financiare për DSHMS me të cilat mjete u planifikua furnizimi me teste serologjike, me qëllim që një pjesë e madhe e qytetarëve të cilët kanë qenë të dyshuar me diagnoz klinike të mjekut familjar apo ndonjë specialisti mjeksorë dhe puntorët e institucioneve publike të cilët kanë qenë më të ekpozuar takimeve me qytetar dhe për të gjithë qytetarët e komunës sonë të cilët nuk ndihem mirë me shëndet apo janë interesuar të testohen.

Rezultati	M	F	GJ	%
Pozitiv	40	41	81	14
Pozitiv (përfundim)	35	26	61	11
Negativ(pa e kaluar)	106	77	183	32
Negativ(e ka kaluar)	122	119	241	43
Gjithsej	303	263	566	100

Duke filluar nga data 21.07.2020 sipas rekomanimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKSHPK- pacientet me Covid -19 duhet të trajtohen ne Kujdesin Parësor Shëndetësorë.

QKMF ka krijuar kushtet për trajtim të pacienteve me Covid-19 ku dhomën e kujdesit për nëna dhe fëmijë e ka kthyer në dhomë për shërbim të pacientëve me Covid-19 dhe dhomën e zhveshtorës së personelit gjithashtu në shërbim dhe trajtim të pacientëve me Covid-19. DSHMS-së ka arritur të krijojë kushte për trajtim të pacienteve gjatë pandemisë ,nga 6 shtreter tani QKMF ka 12 shtreter në disponim përveç 2 shtretëve ne emergjence. Të gjitha këto aktivitete dhe masa të lartpërmendura në raportin përmbyllës për vitin 2020 janë marrë bazuar në vendimet e nivelit qendrorë në parandalim te virusit Covid-19. Pakujdesia e gjithë ne banorë të Komunës mund të shtojnë rrezikun e përhapjes së infeksionit përderisa virusi SARS-COV-2 është prezent dhe kështu mund të mbingarkohet sistemi shëndetësor me pasoja të pa parashikuara e që mund të paraqes rrezik për jetën e qytetarëve.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

- Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020 Qendra për Punë Sociale ka kryer detyrat e zakonshme që i përkasin këtij institucioni.
- Janë mbajtur trajnime për Shërbime Sociale.
 - Bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Gjykatat, Qendrat për Punë Sociale, Departamentin për Politika Sociale dhe Familjare, Departamentin e Mirëqenies Sociale, Shkolla, QKMF, Spitalin e Prishtinës, OSBE, OJQ etj.
 - Kemi vazhduar mbajtjen e mbledhjeve të Tryezave për Menaxhimin e Rasteve ku kemi pasur pjesmarrje nga akterët e nevojshëm për mbrojtjen e femijëve, ku në këto takime kemi identifikuar rastet që mund të i menaxhojmë së bashku me qëllim të ofrimit të një mirëqenie sa më mirë për të gjithë qytetarët.
 - Në vitin 2020 për shkak të Pandemisë COVID 19 kemi pasur shumë angazhime në shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet nevojtare të dhuruara nga donatorë të ndryshëm ku bartës kryesor në përpilimin e listave kemi qenë ne zyrtarët e QPS-së
 - Në bashkëpunim me OJQ “OFAP” kemi pasur një Psikologe në QPS-së me kontratë 3 mujore me mundësi vazhdim ku kemi filluar të trajtojmë raste të ndryshme.
 - Me kërkesë të Departamentit të Mirëqenies Sociale kemi qenë të angazhuar në pranimin dhe regjistrimin në sistem të Pakos emergjente masës 15 në kohë të Pandemisë Covid-19 si kriter familjet me asnjë anëtarë të punësuar ku kemi pasur 275 aplikime dhe më pastaj me ankesat e lëndëve të refuzuara.
 - Kemi pajisur dhe funksionalizuar dhomën e kontaktimeve për prindërit e divorcuar (kontaktime prind-fëmijë) dhe njëherit këtë dhomë do ta shfrytëzojmë për këshillime për fëmijët që kanë nevojë.
 - Kemi ndihmuar në forma të ndryshme Personat me Aftësi të Kufizuara dhe njëherit kemi riaktivizuar OJQ Hendikos në Han të Elezitet.
 - Kemi mbajtur ligjerata në shkollat fillore të mesme të ulët dhe të mesme të lartë me temën “ Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve”

▪ SKEMA E NDIHMËS SOCIALE

Muajt	Nr. i familjeve përfituese në 2019	Nr. i familjeve përfituese në 2020	Arsyetimi
Janar	141	129	
Shkurt	139	127	Nderprerje nga ATK

Mars	137	127	
Prill	131	129	
Maj	127	128	
Qershor	124	126	Punesim
Korrik	124	122	Nderprerje nga sistemi (femijet qe kane mbush 5 vjet, dhe punesim i anetareve e familjes.
Gusht	118	122	
Shtator	115	122	
Tetor	116	122	
Nentor	119	120	Nderprerje nga ATK
Dhjetor	127	127	

Pasqyra tabelare për Skemën Sociale

Shërbimet	2019	2020
Numri i aplikuesve të rinj	6	20
Lëndët dërguar për Komision Mjekësor	99	57
Lëndë të refuzuara nga komisioni mjekësor	00	01
Lëndë të kërkuara për plotësim dokumentacioni nga mjeku	01	00
Lëndët e aprovuar nga Komisioni Mjekësor	98	56
Lëshim të kartonëve të ndihmës sociale	99	76
Verifikim të familjeve që kanë aplikuar dhe riaplikuar për ndihmë sociale	184	78
Riaplikime dhe aplikime për ndihmë sociale	172	146
Vërtetime që gjenden si shfrytëzues i ndihmës sociale	1	2
Konsultim për plotësim dokumentacioni, riaplikime dhe aplikime për ndihmë sociale	20	63

▪ SHËRBIMET SOCIALE

Përshkrimi	2019	2020
Trafikim i qenieve njerëzore	0	0
Përdorimi i substancave narkotike	0	0
Propozim për regjistrimin të mëvonshëm të fëmijëve	2	0
Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe e veprimtimit	65	26
Propozimi Gjykatës themelore për besimin e fëmijëve	1	0
Përkujdesje institucionale e të moshuarve në shtëpi të moshuarve	1	1
Fëmijë me sjellje asociale, Të miturit në konflikt me ligjin	25	13
Vërtetim që nuk është shfrytëzues i ndihmave sociale	10	2
Dhunë në Familje	6	3
Ndërmjetësim bashkëshortor-Sanim të marëdhënies bashkërtore	3	0

Mbikqyrje e shtuar nga Organi i Kujdestarisë për të miturit	4	1
Aplikime për fëmijët me aftësi të kufizuara	5	3
Pagesa për Fëmijët me aftësi të kufizuar	11	12
Pagesa për Fëmijët ne strehim familjar	9	9
Prindërit e aprovuar për adoptim vendor të fëmiut	1	1
Braktisje të fëmiut	0	1
Vërtetim për humbje të shtetësisë	9	2
Konstatime zyrtar	2	3
Përfaqësim në Gjykatë	0	0
Mbrojtja e viktimës së mitur ne stacion policor	20	17
Këshillime psiko-sociale	47	24
Kontaktim fëmijë-prind	11	3
Vizita familjare	123	66
Caktimi i kujdestarisë për të miturit	10	3
Fëmijët me forma të rënda të punës	5	1

INSPEKTIMET SANITARE

Inspektorati sanitarë gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020 kryesisht ka qenë i angazhuar rreth zbatimit të urdhëresave dhe vendimeve të Qeverisë nëpër të gjithë operatorët ekonomik lidhur me masat ndaj pandemisë së Covid - 19 dhe emërgjencës së ndërlidhur të shëndetit publik. Bazuar në këto urdhëresa disa prej operatorëve ekonomik u është ndaluar veprimtaria deri në marrjen e vendimit tjetër nga Qeveria dhe disa të tjerëve ju është lejuar të ushtrojnë veprimtarinë duke marr masa higjienike e parandaluese.

Zbatimi i Legjislacionit dhe akteve tjera në fuqi për luftimin e COVID 19	1844	Inspektime të realizuara në subjekte të ndryshme afariste , shkolla , njoftim me masat e Qeverisë ndaj pandemisë COVID-19 , inspektime me Policinë e Kosovës
Urdhëresë për marrjen e masave për luftim të Covid -19	1	Të cilën e kemi shpërndarë tek të gjitha subjektet afariste ushqimore dhe jo ushqimore markete , banka, farmaci, postë dhe të gjitha subjektet tjera të cilat janë lejuar të ushtrojnë veprimtarinë gjatë gjendjes emërgjente.
Aktvendime rreth zbatimit të Ligjit për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse	19	Bazuar në proformat e policisë .

Gjobë mandatore për mos rrespektim të masave ndaj Covid -19	1	Subjekt afarist (500€)
Vendime për vetëizolim	78	Për personat pozitiv me COVID – 19 dhe antarët e familjes
Vendime për lirim nga izolimi – Covid - 19	61	Bazuar në raportet e IKSHPK-së
Zbatimi i ligjit për kontrollin e duhanit	38	Vërejtje per rrespektim të Ligjit te Duhanit , 2 gjoba mandatore person fizik dhe një fletparaqitje në gjykatë për person përgjegjës
Pëlqime Sanitare	2	542.73€
Fletparaqitje në Gjykatë	465	Bazuar në proformat e policisë

DSHMS
Medina Imishti

